



Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Bazuar në nenin 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 65, datë 05.02.2010), nenin 11 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, (Gazeta Zyrtare nr. 72, datë 25.06.2010) si dhe në nenin 34 (paragrafi 5) të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, (MAP, datë 20.09.2010), Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.07.2013, mori:

V E N D I M

1. Anulohet procedura e rekrutimit për pozitën e karrierës Menaxher i Prokurimit (një pozitë), shpallur me datë 14.05.2013.
2. Obligohet Zyra e Personelit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Vendimi merret në pajtim me nenin 11 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil dhe nenin 34 (paragrafi 5) të Rregullores nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, duke u bazuar në dokumentacionin e ofruar nga Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil pasi që asnjë nga kandidatët për pozitën e lartcekur nuk i ka plotësuar kushtet për seleksionim, andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Hasan PRETENI

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit;
- Zyrës së Drejtorit;
- Zyrës Ligjore;
- Zyrës së Personelit;
- Arkivit.